



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2022-01

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Kai Ambos
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 31 janar 2023

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim i Mëtejshëm mbi Kërkesën F00097 të Gucatit dhe Vendim mbi Kërkesat
për Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara
F00088 dhe F00089**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Hysni Gucatit:
Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt:
Tobi Kadman

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),¹ në pajtim me nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 172 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”) ka marrë: (i) kërkesën e parashtruar nga z. Hysni Gucati (“Gucati”) për riklasifikimin ose nxjerrjen e versioneve të redaktuara publike të pesë vendimeve konfidenciale të Panelit të Apelit (“Kërkesa e Gucatit”);² (ii) kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) për riklasifikimin e parashtrimit të protokolluar konfidencial F00089 si publik (“Kërkesa e ZPS-së”);³ dhe (iii) kërkesën e parashtruar nga z. Nasim Haradinaj (“Haradinaj”), ku i kërkoi Panelit të Apelit që të riklasifikojë parashtrimin e protokolluar konfidencial F00088 si publik (“Kërkesa e Haradinajt”).⁴

1. Më 9 janar 2023, Paneli i Apelit nxori Vendimin për Kërkesën e Gucatit,⁵ ku i urdhëroi Palët të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të tyre në lidhje me pesë vendimet konfidenciale të Panelit të Apelit që ishin objekt i Kërkesës

¹ F00011, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 21 qershor 2022.

² F00097, Kërkesë e Mbrojtjes për Riklasifikim/Versione të Redaktuara Publike të Vendimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit, 29 nëntor 2022 (shpërndarë më 2 dhjetor 2022) (“Kërkesa e Gucatit”), para. 1-14, 26, e cila i referohet parashtrimit të protokolluar F00044/CONF/RED, Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit në lidhje me Njoftimet e Prokurorisë, 26 shtator 2022 (konfidencial) (versioni konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 15 shtator 2022); F00075, Vendim mbi Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar në lidhje me Materialin 206, 21 tetor 2022 (konfidencial); F00083, Vendim mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mjete Juridike Alternative lidhur me Shkeljen e Detyrimit për Nxjerrjen e Materialit sipas Rregullës 103, 7 nëntor 2022 (konfidencial); F00090, Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Mocioneve të Mundshme sipas Rregullës 181, 9 nëntor 2022 (konfidencial); F00094, Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Intervistim të Dëshmitarëve, Urdhërimin e Një Njoftimi të Përditësuar sipas Rregullës 102(3) dhe Shtyrjen e Seancës së Apelit, 28 nëntor 2022 (konfidencial). ZPS-ja nuk ktheu përgjigje.

³ F00104, Kërkesë e Prokurorisë për Riklasifikimin e Parashtrimit KSC-CA-2022-01/F00089, 12 janar 2023 (“Kërkesa e ZPS-së”). Kjo kërkesë ka të bëjë me: F00089, Përgjigje e Prokurorisë në lidhje me Kërkesën për Zgjatjen e Afatit për Parashtrimin e Mocioneve për Prova Shtesë në Apel, 8 nëntor 2022 (konfidencial).

⁴ F00107, Kërkesë e Mbrojtjes së Haradinajt për Riklasifikimin e Parashtrimit KSC-CA-2022-01/F00088, 19 janar 2023 (“Kërkesa e Haradinajt”). Kjo kërkesë ka të bëjë me: F00088, Kërkesë e Haradinajt për t’iu Bashkuar Kërkesës së Gucatit KSC-CA-2022-01/F00087, 8 nëntor 2022 (konfidencial).

⁵ F00103, Vendim mbi Kërkesën e Gucatit për Riklasifikimin e Versioneve të Redaktuara Publike të Vendimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit, 9 janar 2023 (“Vendimi mbi Kërkesën e Gucatit”).

së Gucatit dhe dy parashtrimet e protokolluara shtesë në lidhje me dy vendimet shtesë të Panelit të Apelit,⁶ ose të bëjnë parashtrime se përse nuk mund të dorëzoheshin (ende) versionet e redaktuara publike të disa parashtrimeve të protokolluara brenda shtatë ditësh nga njoftimi i vendimit në lidhje me kërkesën e Gucatit, me qëllim nxjerrjen e versioneve të redaktuara publike të vendimeve që rrjedhin nga këto parashtrime të protokolluara.⁷

2. Me marrjen e versioneve të redaktuara publike të dorëzuara nga palët,⁸ si dhe të Kërkesës së ZPS-së dhe Kërkesës së Haradinajt, Paneli njofton palët se, në përputhje

⁶ Vendim mbi Kërkesën e Gucatit, poshtëshënimi 11, i cili i referohet parashtrimin të protokolluar F00049/CONF/RED, Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit në lidhje me Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse, 26 shtator 2022 (konfidencial) (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 23 shtator 2022); F00096, Vendim mbi Kërkesën e Gucatit për Nxjerrje të Plotë të Informacionit lidhur me Dijeninë e Panelit të Gjykatës së Apelit për Hetimet e Mbrojtjes, 30 nëntor 2022 (konfidencial).

⁷ Vendim mbi Kërkesën e Gucatit, para. 4-6.

⁸ F00028/RED, Version i Redaktuar Publik i Njoftimit në lidhje me Kontaktin Telefonik me W04730-n, 12 janar 2023 (versioni konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 7 korrik 2022, versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 23 shtator 2022); F00038/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Njoftimit lidhur me Komunikimin e Marrë nga ZPS-ja, 12 janar 2023 (versioni konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 7 shtator 2022, versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 23 shtator); F00045/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Kërkesës për Masa Mbrojtëse, 12 janar 2023 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 19 shtator 2022); F00046/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Njoftimit të Prokurorisë për Materialin Shtesë 206 dhe Kundërshtimit për Nxjerrjen e Tij, 12 janar 2023 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 19 shtator 2022, versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 23 shtator 2022); F00050/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Përgjigjes së Gucatit ndaj Njoftimit të Mbrojtjes për Materialin Shtesë 206 dhe Kundërshtimit për Nxjerrjen e Tij, 20 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 29 shtator 2022); F00051/RED, Versioni i redaktuar Publik i Përgjigjes së Mbrojtjes së Haradinaj ndaj Njoftimit të Prokurorisë për Materialin Shtesë 206 dhe Kundërshtimit për Nxjerrjen e Tij, 19 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 29 shtator 2022); F00068/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Mocionit të Gucatit për Mjete Ligjore Alternative në lidhje me Shkeljen e Detyrimit për Nxjerrjen e Materialit, konkretisht të Urdhrit për Prapësimin e Verdikteve të Fajësisë, më anë të një Vendimi për Pezullim ose Urdhri për Rigjykim, 20 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 17 tetor 2022); F00073/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Mocionit të Haradinajt për Mjet Juridik për Shkelje të Rregullës 103, 20 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 18 tetor 2022); F00076/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Përgjigjes Përmbledhëse ndaj Kërkesave të Mbrojtjes sipas Rregullës 103, 12 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 27 tetor 2022); F00078/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Kundërpërgjigjes së Gucatit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Kërkesave të Mbrojtjes sipas Rregullës 103 dhe Kërkesave në lidhje me Të për Rishqyrtim, 20 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 nëntor 2022); F00079/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Kërkesës së Mbrojtjes për një Urdhër për Nxjerrjen e të Dhënave të Kontakteve, 19 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 2 nëntor 2022); F00080/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Kundërpërgjigjes së Mbrojtjes ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të ZPS-së ndaj Kërkesave të Mbrojtjes sipas Rregullës 103 dhe Kërkesave në lidhje me Të për Rishqyrtim, 19 janar 2023 (versioni konfidencial

me Vendimin mbi Kërkesën e Gucatit,⁹ do të nxjerrë versionet e redaktuara publike të vendimeve të Panelit të Apelit si vijon: F00044, F00049, F00075, F00083, F00090, F00094 dhe F00096.

3. Paneli më tej vëren se parashtrimet e protokolluara F00088 dhe F00089 nuk përmbajnë ndonjë informacion konfidencial dhe, për rrjedhojë, mund të riklasifikohen si publike.

4. Për arsyet e lartpërmendura, Paneli i Gjykatës së Apelit:

MIRATON kërkesën e Gucatit;

MIRATON kërkesën e Haradinajt dhe kërkesën e ZPS-së; dhe

URDHËRON riklasifikimin e parashtrimeve të protokolluara F00088 dhe F00089 sipas rregullës 82(5) të Rregullores.

u dorëzua më 2 nëntor 2022); F00081/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Kërkesës së Gucatit për (i) një Deklaratë se Rregulla 102(3) Është e Zbatueshme në Procesin e Apelit; dhe (ii) një Urdhër për Nxjerrjen e të Dhënave të Kontaktit të Dëshmitarëve, 20 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 2 nëntor 2022); F00087/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Kërkesës për Zgjatje të Afatit për Dorëzim të Mocioneve për Paraqitje të Provave Shtesë sipas Rregullës 181 Panelit të Gjykatës së Apelit, 19 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 7 nëntor 2022); F00091/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Kërkesave të Mbrojtjes për Nxjerrjen e Materialit, 12 janar 2023 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 11 nëntor 2022, versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 11 nëntor 2022); F00093/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Kërkesës së Haradinajt për Shtyrje të Seancës Gojore të Apelit, 24 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 28 nëntor 2022); F00095/RED2, Versioni i Redaktuar Publik i Kërkesës Urgjente për Nxjerrjen e Plotë të Informacionit lidhur me Dijeninë e Panelit të Gjykatës së Apelit për Hetimet e Mbrojtjes, 30 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 29 nëntor 2022).

⁹ Vendim mbi Kërkesën e Gucatit, para. 4-5.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar
Kryegjykatëse

E martë, 31 janar 2023

Në Hagë, Holandë